



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2021:046465  
Datë: 26.05.2022  
Numri i dokumentit: 03062537

**PPP.nr.88/21**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbartimore të kreditorit “K...”, sh.p.k, me seli në fsh ..., Komuna e Ferizajt, me pronar V.Sh, të cilën e përfaqëson av Arlinda Haziri nga Ferizaj, kundër debitorit “L...” sh.p.k, me seli në fsh ....., Komuna e Ferizajt, me numër unik identifikues ... me pronar L.A, D.D, të cilën me autorizim e përfaqëson av Jeton Berisha nga Ferizaj, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga i autorizuari i debitorit, më datë 26.05.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i të autorizuarit të debitorit “L...” sh.p.k, i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.392/2020, të datës 10.12.2020, i lëshuar nga përmbartuesi privat Mubarak Shumolli nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.392/2020, i datës 10.12.2020.

**II DETYROHET** debitori “L...” sh.p.k, nëse parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, që në bazë të nenit 78, par 1 dhe 2, të LPP-së, ta deponoj në llogarinë e kësaj gjykate shumë e garancionit prej 13,844.44 euro.

**A r s y e t i m**

Me urdhrin P.nr.392/2020, të datës 10.12.2020, përmbartuesi privat Mubarak Shumolli e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit “K...”, sh.p.k, kundër debitorit “L...” sh.p.k, për detyrimin e debitorit, për pagesën e borxhit në shumë të përgjithshme prej 13,844.44 euro dhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit, në bazë të faturave: Nr.51, e datës 17.07.2020, Nr.54, e datës 25.07.2020, Nr.64, e datës 11.08.2020 dhe Nr.66, e datës 13.08.2020, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të kreditorit apo

regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të palujtëshme të debitorit.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, i autorizuari i debitorit, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi si i bazuar.

I autorizuari i kreditorit ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e të autorizuarit të debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhëri për përmbarim.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përmbarimit dhe pretendimet në prapësim të të autorizuarit të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata me rastin e rishikimit të procedurës së përmbarimit në bazë të nenit 43, par 4, të LPP-së, vlerësoj se urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.392/2020, i datës 10.12.2020, i lëshuar nga përmbaruesi privat Mubarak Shumolli, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njejti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, sepse përmbaruesi privat në këtë rast e ka lejuar përmbarimin në bazë të nenit 29, par 1, nën par 1.3, të LPP-së, në të cilin është përcaktuar shprehimisht se fatura konsiderohet dokument i besueshëm në bazë të cilës mundë të caktohet përmbarimi.

Sa i përket pretendimeve të të autorizuarit të debitorit në prapësim se përfaqësuesi i debitorit më datë 29.08.2020, përmes postës elektronike menjëher e kishte njoftuar kreditorin për ankesat që i ishin paraqitur lidhur me cilësinë e asfaltit meqë cilësia nuk ishte ajo e kontraktuar dhe nuk i përmbushë standardet minimale të marrëveshjes, si rezultat i cilësisë së dobët debitorit i ishte kërkuar nga investitori në Prizren të cilit i ishte kërkuar gërryerja e shtresës së dytë të asfaltit dhe shtrurja e asfaltit tjetër të cilësisë së mirë. Mos pagesa e faturave ka mbetë e pa definuar jo për shkak se debitori ka refuzuar t'ia paguaj por për shkak të kualitetit të dobët të asfaltit të cilat debitori i ka blerë nga kreditori dhe nga kjo debitori ka pësuar dëm të konsiderueshëm, Gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara për arsye se gjykata me rastin e vendosjes lidhur me prapësimin e debitorit nuk ka kompetencë dhe të drejtë të bëjë një vërtetim ndryshe të gjendjes faktike nga ajo e cila është theksuar në faturat e propozuara, përndryshe një gjë e tillë mund të bëhet vetëm në procedurën kontestimore të inicuar nga palët. Përveq tjerash, të gjitha faturat e cekura më lart janë të nënshkruara nga të dy palët dhe të vulosura. Po ashtu, gjykata konstatoj se faturat në fjalë i plotësojnë të gjitha kushtet e nevojshme ligjore të përcaktuara nga neni 29, par 3, të LPP-së, të cilat konsiderohen dokumente të besueshme në bazë të cilave mund të caktohet përmbarimi.

Gjithashtu, siç konstatohet nga shkresat e lëndës dhe pas analizimit të të gjitha faturave veç e veç, Gjykata ka konstatuar se faturat e cekura më lartë në këtë aktvendim janë në tërësi të përshtatshme për përmbarim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, sepse në fatura janë treguar të dhënat e kreditorit dhe debitorit, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Gjithashtu në fatura është shënuar edhe koha e arritjes së kërkesës së

kreditorit për arkëtim që nënkupton se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 30 dhe neni 36, par 1, të LPP-së.

Po ashtu, Gjykata konstatoj se propozimi për përmbarrim i kreditorit, në bazë të cilit është nxjerr urdhëri për përmbarrim në rastin konkret, është përpiluar në pajtim të plot me nenin 38, par 1 dhe 2, të LPP-së, për shkak se propozimi e përmbanë kërkesën për përmbarrim në të cilën janë treguar të gjitha faturat si dokumente të besueshme, po ashtu i përmban të dhënat e plota të kreditorit dhe debitorit duke e përfshirë adresën e selisë së kreditorit e posaçërisht të debitorit, numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit si dhe të gjitha të dhënat e tjera që konsiderohen të nevojshme për ta zbatuar përmbarrim në fjalë. Po ashtu është me rëndësi të theksohet se i autorizuari i debitorit në pretendimet e tij në prapësim nuk e ka mohuar borxhin që ka ndaj kreditorit për që vetëm ka theksuar se ka vërejtje në cilësinë e asfaltit të cilin e ka marr nga kreditori.

Gjykata me rastin e detyrimit të debitorit si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, që në rast të ushtrimit të ankesës kundër këtij aktvendim, ta deponoj shumën e mjeteve prej 13,844.44 euro, në emër të garancionit, është bazuar në nenin 78, par 1 dhe 2, të LPP-së.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e të autorizuarit të debitorit në prapësim, thëniet e të autorizuarit të kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, si dhe provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri mbi lejimin e përmbarrimit P.nr.392/2020, i datës 10.12.2020, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe në bazë të neni 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP – së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**PPP.nr.88/21, më datë 26.05.2022**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykates së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.